



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 17, datë 30.10.2018

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË KUVENDIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË KOMISIONIT EUROPIAN PËR
SHQIPËRINË PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

- I. Miratohet Plani i Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- II. Ngarkohen organet e Kuvendit, deputetët dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin në kohë dhe me cilësi të masave të parashikuara në këtë Plan Veprimi.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit t'i dërgojë Konferencës së Kryetarëve, raportim periodik çdo një muaj e gjysmë për ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruci



**PLANI I VEPRIMIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË VITIT 2018
TË KOMISIONIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË¹**

OBJEKTIVI I: FORCIMI I FUNKSIONIT LIGJVËNËS TË KUVENDIT

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon hartimin dhe miratimin e amendimeve të kuadrit ligjor për zgjedhjet me qëllim adresimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve të viteve 2013, 2015 dhe 2017 në Shqipëri. Gjithashtu parashikohen masa të cilat synojnë forcimin e kapaciteteve të Kuvendit për shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së, me qëllim për të garantuar një përafrim më efektiv dhe cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar.

GJETJE/ REKOMANDIME TË RAPORTIT TË KE 2018	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR²	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
1. Një Komision i ri i Posaçëm Parlamentar u krijua në tetor të vitit 2017 për të adresuar rekomandimet e OSBE/ ODIHR-it për tre zgjedhjet e fundit (2013, 2015 dhe 2017). <u>Komisioni i Posaçëm Parlamentar për</u>	1.1 Hartimi dhe miratimi i projektligjit <i>“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, i cili adreson të gjitha rekomandimet e raporteve të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve të viteve 2013, 2015 dhe 2017 në Shqipëri.</i>	Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngritur me Vendimin e Kuvendit Nr. 102/2017; Kuvendi/ Seancë Plenare, Grupi i ekspertëve,	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	Viti 2018	

¹ Miratuar me vendimin nr. 17, datë 30.10.2018 të Konferencës së Kryetarëve

² Afati maksimal për realizimin e masave të parashikuara në këtë Plan Veprimi duhet të jetë muaji Prill 2019, kur pritet të publikohet Raporti i KE-së për Shqipërinë për vitin 2019.

<u>Reformën Zgjedhore që sapo është krijuar duhet të adresojë rekomandimet e OSBE/ ODIHR-it në mënyrë gjithëpërfshirëse, përpara zgjedhjeve lokale të vitit 2019.</u>		Stafi i Komisionit.			
	1.2 Hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar”.	Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore; Kuvendi/ Seancë Plenare, Grupi i ekspertëve, Stafi i Komisionit.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	Viti 2018	
<u>2. Kapaciteti i përgjithshëm i parlamentit për të monitoruar zbatimin e legjislacionit të ri dhe përputhshmërinë e tij me acquis mbetet i kufizuar.</u>	2.1 Publikimi i Manualit “Mbi sistemin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së, në nivel parlamentar”.	Zyra e Projekteve, SHPL, (Ekspertët e projektit twinning).	Fondet IPA 2014 ²	Tetor 2018	
	2.2 Krijimi i një database-i parlamentar për përafrimin e legjislacionit.	Zyra e Projekteve; SHPL, (Ekspertët e projektit twinning).	Fondet IPA 2014	Tetor 2018	

² Projekti i Binjakëzimit “Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE”, në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë, i cili u implementua gjatë periudhës 5 maj 2017- 25 maj 2018.

	2.3 Monitorimi efektiv i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me aquis të BE-së, me qëllim për të garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar.	KIE; Komisionet e Përhershme të Kuvendit, SHPL	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	2018 dhe në vazhdim.	
3. Rregullorja e Parlamentit duhet të pasqyrojë <u>ligjin mbi rolin e Parlamentit në procesin e integritetit në BE</u>, i miratuar në mars të vitit 2015.	3.1 Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, me qëllim përshtatjen e saj me dispozitat e ligjit mbi rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE (ligji nr. 15/2015).	Këshilli për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin, Kuvendi/ Seancë Plenare, SHPL, Shërbimi Juridik, Shërbimi i Komisioneve.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit	Janar 2019	

OBJEKTIVI II: FORCIMI I ROLIT MBIKËQYRËS TË KUVENDIT

Përveç masave të cilat synojnë forcimin e rolit kontrollues të Kuvendit mbi veprimtarinë e qeverisë në përgjithësi dhe në çështjet e integritetit evropian në veçanti, kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon edhe masa të cilat synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura me qëllim garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjëshmërisë së tyre.

II.a FORCIMI I MËTEJSHËM I ROLIT MBIKËQYRËS TË KUVENDIT

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon masa të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi veprimtarinë e qeverisë, përmes përdorimit më intensiv të instrumentave të kontrollit parlamentar, të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

GJETJE/ REKOMANDIME TË RAPORTIT TË KE 2018	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
<u>1. Nevojiten më shumë përpjekje për të arritur mbikëqyrje efektive.</u> <u>Duhet përmirësuar koordinimi me ekzekutivin.</u> <u>Puna e komisioneve hetimore mbeti shumë konfliktuale dhe munguan rezultatet.</u> <u>Mekanizmat e tjerë të mbikëqyrjes u shfrytëzuan pak.</u> <u>Gjatë vitit të fundit ka patur pak pyetje drejtuar Kryeministrit dhe ministrave dhe në komisionet parlamentare janë zhvilluar pak seanca dëgjimore për mbikëqyrje.</u>	1.1 Ushtrimi më sistematik i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj veprimtarisë së qeverisë, lidhur me zbatimin e ligjeve dhe politikave, përmes: - Përdorimit më intensiv të interpelancave, pyetjeve me shkrim, pyetjeve me gojë, pyetjeve në Komisione, mocioneve për debat dhe kërkesave për informacion; - Planifikimit sistematik të veprimtarisë kontrolluese nga çdo Komision i përhershëm parlamentar sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, duke përgatitur një kalendar kontrolli/ monitorimi, - Organizimit periodik nga komisionet e përhershme parlamentare të seancave dëgjimore me ministrat dhe me zyrtarë të tjerë të lartë të qeverisë, me qëllim marrjen e informacioneve dhe të shpjegimeve për çështjet që lidhen me veprimtarinë e tyre.	Deputetët; Komisionet parlamentare; Kuvendi/ Seancë Plenare; Shërbimi Juridik, Shërbimi i Komisioneve, Shërbimi i Seancës Plenare.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	Në vazhdimësi	

	1.2 Ngritja dhe funksionimi i komisioneve hetimore parlamentare në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.	Grupet Parlamentare, Depuetet anëtarë të Komisioneve Hetimore të ngritura nga Kuvendi, Kuvendi/ Seancë Plenare. Shërbimi Juridik.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	

II.b FORCIMI I ROLIT MBIKËQYRËS TË KUVENDIT DHE FORCIMI I BASHKËPUNITIT DHE MONITORIMIT MBI INSTITUCIONET E PAVARURA

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon masa të cilat synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit dhe Qeverisë me institucionet e pavarura me qëllim garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre. Parashikohet zbatimi i masave dhe planeve të veprimit të Mekanizmit ndërintitucional “Qeveri-Kuvend-Institucione të Pavarura, me qëllim ndjekjen dhe zbatimin efikas të rekomandimeve të institucioneve të pavarura” si dhe procesi zgjedhës dhe buxhetor i tyre.

GJETJE/ REKOMANDIME TË RAPORTIT TË KE 2018	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
---	----------------------	------------------------------	-------------------------	--------------------	---------------------------------------

1. Parlamenti zhvilloi një shqyrtim të strukturuar të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura dhe miratoi 15 rezoluta, të cilat nuk u diskutuan në seancë plenare.	1.1 Ushtrimi sistematik i funksionit mbikqyrës të Kuvendit ndaj veprimtarisë së institucioneve të pavarura përmes: - Shqyrtimit nga Kuvendi/Komisionet e përhershme parlamentare, të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, duke zbatuar procedurat dhe afatet ligjore të raportimit në Kuvend që parashikohen në Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit (Neni 103) dhe ligjet organike që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve.	Komisionet parlamentare, Kuvendi/Seancë Plenare, Sherbimi i Monitorimit të Institucioneve (SHMI), Sherbimi Legjislativ.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim	
2. Vendimi i prillit 2017, për krijimin e një sistemi për ndjekjen dhe monitorimin e rekomandimeve nga Parlamenti dhe institucionet e pavarura shënoi një hap para drejt mbikëqyrjes më të fortë në këtë drejtim.	2.1 Zbatimi i mekanizmit ndërinstitutional “Qeveri-Kuvend-Institucione të Pavarura”, i miratuar me vendimin e Kuvendit nr.49/2017, për ndjekjen dhe monitorimin sistematik të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.	Kuvendi, Organet e Kuvendit, Komisionet Parlamentare, Zëvendëskryemi nistri, Institucionet e Pavarura, SHMI, Shërbimi Legjislativ.	Buxheti i Kuvendit, Kostot shtesë mund të mbulohen nga buxheti i Zëvendëskryeministrit.	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	
	2.2 Zbatimi i planit të masave të Mekanizmit të parashikuara në Planin e Veprimit për 6-mujorin e parë 2018, masat e mbetura, si dhe	Kuvendi, Organet e Kuvendit, Komisionet	Buxheti i Kuvendit, Kostot shtesë mund të	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	

	hartimi, miratimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit për 6-mujorin e dytë 2018, të lidhura me përmbushjen e nënshtyllave kryesore të ndërvarura dhe të lidhura nga bashkëkordinimi i Qeverisë (Zëvendëskryeministrit), Parlamentit (Organeve të Kuvendit) dhe institucioneve të pavarura. Këto masa të përshtatura me konstatimet dhe rekomandimet e Raportit 2018 të KE-së për Shqipërinë, dhe për atë që është e mundur, me rekomandimet e dhëna për Kuvendin gjatë zbatimit të projektit të binjakëzimit IPA 2018.	Parlamentare, Zëvendëskryeministri, Institucionet e Pavarura, SHMI, Shërbimi Legjislativ.	mbulohen nga buxheti i Zëvendëskryeministrit.		
3. Avokati i popullit, si dhe kryetari dhe një anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, u emëruan si pjesë e marrëveshjes politike të 18 majit.	3.1 Ushtrimi i funksionit zgjedhës të Kuvendit për plotësimin e vendeve vakante në institucionet e pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj sipas përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore, kur ato krijohen, në zbatim të procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kushtetutë, ligjin specifik dhe nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.	Organet e Kuvendit, Komisionet parlamentare, Kuvendi/ Seance plenare, SHMI, Shërbimi Legjislativ.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit	Në vazhdim, kur krijohet vakanca.	
4. Raporti i KE-së sjell në vëmendje të vazhdueshme forcimin e pavarësisë së institucioneve të ndryshme të pavarura	4.1 Mbështetja buxhetore dhe strukturore e institucioneve të pavarura me qëllim rritjen e efikasitetit dhe pavarësisë së tyre si dhe forcimin e kapaciteteve të tyre njerëzore.	Komisionet Parlamentare, Kuvendi/Seancë Plenare, SHMI.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	

kushtetuese dhe të krijuara me ligj.					
---	--	--	--	--	--

II.c FORCIMI I ROLIT KONTROLLUES TË KUVENDIT NË ÇËSHTJET E INTEGRIMIT EUROPIAN

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon masa konkrete të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të rolit kontrollues të Kuvendit dhe në veçanti të Komisionit për Integrimin European mbi veprimtarinë e Qeverisë në kuadër të procesit të integrimit European të Shqipërisë. Gjithashtu parashikohen masa të cilat synojnë forcimin e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar për Integrimin European, me qëllim që ky institucion të përmbushë plotësisht rolin e tij, si forum për përfshirje të gjerë dhe konsultime për çështjet e integrimit european.

GJETJE/ REKOMANDIME TË RAPORTIT TË KE 2018	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
1. Komisioni për Integrimin European ka zhvilluar disa seanca dëgjimore për funksionin e kontrollit parlamentar gjatë periudhës së raportimit. <u>Kapaciteti i përgjithshëm i parlamentit për të monitoruar zbatimin e legjisllacionit të ri dhe përputhshmërinë e tij me <i>acquis</i> mbetet i kufizuar.</u>	1.1 Mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga MSA Shqipëri-BE, përmes përdorimit më sistematik dhe intensiv të instrumentave të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.	KIE, Komisionet e tjera të Përhershme të Kuvendit, KKIE, Shërbimi i Komisioneve, Sekretariati Teknik i KKIE.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	
	1.2 Mbikëqyrja e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin European 2018-2020.	KIE, KKIE Shërbimi i Komisioneve, Sekretariati Teknik i KKIE.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	

	1.3 Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Komisionit European 2018 për Shqipërinë.	KIE, KKIE Shërbimi i Komisioneve, Sekretariati Teknik i KKIE	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	
	1.4 Shqyrtimi në mënyrë periodike i Raportimeve që Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme i dërgon Komisionit European dhe institucioneve të tjera Europiane, lidhur me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe procesi i integrimit.	KIE Shërbimi i Komisioneve.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend.	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	
	1.5 Monitorimi i kuadrit të përgjithshëm të bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë në BE, përmes mbikëqyrjes së zbatimit të kuadrit përkatës rregullator dhe zhvillimit të takimeve periodike me drejtuesit e grupit negociator dhe drejtuesin e delegacionit shqiptar në bisedimet për anëtarësim në BE.	KIE, Komisionet e përhershme të Kuvendit, Shërbimi i Komisioneve, SHPL.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend.	Pas fillimit të <u>bisedimeve për anëtarësim</u> në BE.	
2. Kapaciteti i Këshillit Kombëtar për Integrimin European është forcuar me një njësi mbështetëse të përkushtuar, e cila	2.1 Organizimi i takimeve periodike sipas parashikimit në Rregulloren e KKIE me qëllim garantimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e Integrimit European.	KKIE, Sekretariati Teknik i KKIE.	Buxheti i Kuvendit.	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	

<u>mbetet për tu plotësuar me staf.</u> <u>Këshilli ka zhvilluar disa konsultime dhe sesione trajnimi, por ende nuk e ka përmbushur plotësisht rolin e tij si një forum për përfshirje të gjerë dhe konsultim mbi çështjet e integritetit në BE.</u>					
	2.2 Rinovimi i anëtarësisë së organizatave shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të medias në KKIE në përputhje me parashikimet e Rregullores së KKIE (neni 5).	KKIE, Sekretariati Teknik i KKIE	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend.	3-mujori i katërt 2018	
	2.3 Organizimi i tryezave të rrumbullakëta mbi çështjet e Integritetit European me qëllim sigurimin e zhvillimit të debatit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile dhe me të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në proces.	KKIE, Sekretariati Teknik i KKIE	Buxheti i Kuvendit.	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim	
	2.4 Organizimi i Shkollës Verore Europiane 2018.	KKIE, Sekretariati Teknik i KKIE	Buxheti i Kuvendit dhe Donatorët.	Shtator-tetor 2018	
	2.5 Hartimi i Programit të Punës të KKIE për vitin 2019 (neni 11 i rregullores së KKIE).	KKIE, Sekretariati Teknik i KKIE	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend.	3-mujori i parë 2019	
	2.6 Hartimi i Raportit Vjetor të KKIE për vitin 2018 (neni 11 i rregullores së KKIE).	KKIE, Sekretariati Teknik i KKIE	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvend.	Mars 2019	

OBJEKTIVI III: PËRMIRËSIMI I ETIKËS PARLAMENTARE

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon masa konkrete të cilat synojnë përmirësimin e etikës parlamentare përmes zbatimit të Kodit të Sjelljes së Deputetëve si dhe hartimit dhe miratimit të manualit shpjegues për zbatimin e Kodit të Sjelljes.

GJETJE/ REKOMANDIME TË RAPORTIT TË KE 2018	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
1. <u>Nevojiten më shumë përpjekje për të rritur sjelljen etike.</u> Pavarësisht sjelljes së përmirësuar në seancat plenare, <u>rregullat procedurale ndonjëherë nuk respektohen dhe pritshmëritë e publikut shpesh nuk përmbushen.</u>	1.1 Respektimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes së Deputetëve, i miratuar me vendimin nr. 61/2018 të Kuvendit.	Kuvendi, Deputetët, Personi i Kontaktit për zbatimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve, caktuar urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm Nr.187, datë 18.05.2018.	Nuk ka kosto shtesë në buxhetin e Kuvendit.	Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim.	
	1.2 Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e Kodit të Sjelljes së Deputetëve të nxirret udhëzuesi i detajuar për sjelljen në Kuvend.	Byroja e Kuvendit; Kontaktit për zbatimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve, caktuar urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm Nr.187, datë 18.05.2018.	Nuk ka kosto shtesë në buxhetin e Kuvendit.	3-mujori i katërt 2018	

OBJEKTIVI IV: FORCIMI I TRANSPARENCËS SË KUVENDIT

Masat e parashikuara në këtë pjesë të Planit të Veprimit synojnë rritjen e perceptimit të publikut për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin, si dhe rritjen e perceptimit publik për Kuvendin si një institucion plotesisht i hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruuese të vendit.

GJETJE/ REKOMANDIME TË RAPORTIT TË KE 2018	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
1. Për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies, Parlamenti në përgjithësi ka garantuar akses në dokumente dhe aktivitete. Një strategji dyvjeçare e komunikimit u miratua në maj 2017. <u>Nevojiten më shumë përpjekje për të rritur transparencën.</u>	1.1 Instalimi i Sistemit audio-video në sallat e komisioneve parlamentare.	Zyra e Projekteve, Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit, Shërbimi i Mirëmbajtjes, Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun.	Fondet IPA 2014 ³ ; TVSH 20 % nga Buxheti i Kuvendit.	2018	
	1.2 Projektimi dhe zbatimi i teknologjive të reja në fushën e informatizimit dhe të automatizimit në Kuvend.	Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit	Buxheti i Shtetit	2018	
	1.3 Implementimi i një sistemi Case Management për dixhitalizimin e proceseve të ndryshme administrative në Kuvendin e Shqipërisë.	Deputetët e Kuvendit, Shërbimet e Kuvendit.	Buxheti i Shtetit	2018	
	1.4 Hartimi i produkteve kërkimore në	Shërbimi i	Nuk ka kosto	2018 dhe	

³ Kontratë "Furnizimi dhe instalimi i një sistemi audio-video në mjediset e Kuvendit", në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë.

	mbështetje të veprimtarisë legislative të Kuvendit.	Kërkimit Parlamentar	shtesë	në vazhdim	
	1.5 Sigurimi i një baze të plotë të dhënash për kërkimin parlamentar për plotësimin në kohë dhe me cilësi të kërkesave të përdoruesve, gjithashtu dhe për përgjigjen në kohë dhe me cilësi ndaj kërkesave të ECPRD-së, si tregues të një shërbimi cilësor dhe efikas.	Shërbimi i Kërkimit Parlamentar	Buxheti i Shtetit	2018	
	1.6 Zhvillimi i aktiviteteve profesionale për informimin e opinionit publik mbi veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë me synim përmirësimin e imazhit dhe rritjen e perceptimit publik për rolin e Kuvendit në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit, duke stimuluar pjesëmarrjen e nxënësve dhe studentëve në veprimtaritë e hapura parlamentare.	Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun; Shërbimi i Botimit Parlamentar; Shërbimet e Kuvendit.	Buxheti i Shtetit, Donacion	2018	
	1.7 Publikimi i materialeve informuese dhe edukuese mbi veprimtarinë parlamentare dhe historinë dhe zhvillimet e parlamentarizmit në Shqipëri.	Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit.	Buxheti i Shtetit. Donacion	2018	
	1.8 Publikimi i kërkesave për informacion të deputetëve drejtuar anëtarëve të Këshillit të Ministrave ose titullarëve të institucioneve si dhe	Zyra e Protokollit; Shërbimi i Teknologjisë së	Nuk ka kosto shtesë në buxhetin e Kuvendit.	Gjatë vitit 2018 e në vazhdim.	

	përgjigjet e dhëna prej tyre.	Informacionit.			
	1.9 Përdorimi i plotë i sistemit <i>E-parlament</i> .	Deputetët, Shërbimet e Kuvendit.	Nuk ka kosto shtesë në buxhetin e Kuvendit.	Gjatë vitit 2018 e në vazhdim.	
	1.10 Hartimi, miratimi dhe publikimi i Raportit të Kuvendit mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2018.	Koordinatori për Shoqërinë Civile, Shërbimi i Komisioneve	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit	Mars 2019	
	1.11 Përgatitja dhe publikimi periodik <i>online</i> i <i>Newsletter</i> mbi aktivitetet e Kuvendit lidhur me procesin e integritetit europian të Shqipërisë.	SHPL; Sekretariati Teknik i KKIE;	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit	Janar 2019 dhe në vazhdim.	
2. Rregullsia e seancave dëgjimore me qeverinë dhe grupet e interesit në nivel komisionesh është rritur.	2.1 Zhvillimi i seancave dëgjimore publike nga komisionet e përhershme për marrjen e mendimeve edhe nga aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjeve si dhe gjatë procesit të shqyrtimit dhe të vlerësimit në Kuvend të veprimtarisë së institucioneve të pavarura, duke respektuar programet dhe kalendaret e miratuara nga Kuvendi për periudhat respektive.	Komisionet e përhershme parlamentare, Shërbimi Legjislativ.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	2018 dhe në vazhdim.	

OBJEKTIVI V: FORCIMI I AUTONOMISË FINANCIARE DHE BUXHETORE TË KUVENDIT

Autonomia financiare dhe buxhetore e Parlamentit është e domosdoshme në një vend demokratik dhe një nga parakushtet për një ndarje efektive të pushteteve, sipas nenit 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon masa të cilat synojnë forcimin e autonomisë financiare dhe buxhetore të Kuvendit.

REKOMANDIME TË PROJEKTEVE TË BINJAKËZIMIT (IPA 2013 ⁴ DHE IPA 2018) ⁵	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
	1.1 Hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për Buxhetin e Kuvendit”, i cili parashikon procedurat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Kuvendit në mënyrë të pavarur nga Qeveria.	Sekretari i Përgjithshëm, Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, Byroja e Kuvendit, Kuvendi/Seancë Plenare.	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit	3-mujori i parë 2019.	
	1.2 Rishikimi i Rregullores së Kuvendit me qëllim përshtatjen e saj me dispozitat e ligjit të ri “Për Buxhetin e Kuvendit”.	Sekretari i Përgjithshëm, Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,	Nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Kuvendit.	3-mujori i parë 2019	

⁴ Projekti i Binjakëzimit "Forcimi i Kuvendit të Shqipërisë", në kuadër të IPA 2010 për Shqipërinë, zbatuar gjatë periudhës janar 2012 - qershor 2013.

⁵ Projekti i Binjakëzimit “Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE”, në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë, zbatuar gjatë periudhës maj 2017 - maj 2018.

		Byroja e Kuvendit, Kuvendi/Seancë Plenare.			
--	--	--	--	--	--

OBJEKTIVI VI: FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË KUVENDIT

Masat që parashikon kjo pjesë e Planit të Veprimit synojnë forcimin e mëtijshëm të kapaciteteve administrative dhe ekspertizës së Kuvendit, përmes trajnimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të kapaciteteve të të gjitha shërbimeve të Kuvendit, si dhe forcimin e lidhjeve të deputetëve me zonat e tyre elektorale.

GJETJE/ REKOMANDIME TË RAPORTIT TË KE 2018	MASA KONKRETE	STRUKTURA PËRGJEGJËSE	EFEKTI FINANCIAR	AFATI KOHOR	STATUSI I REALIZIMIT TE MASAVE
1. Ka vazhduar rishikimi i rregulloreve të brendshme për organizimin e administratës së parlamentit si dhe trajnimi i saj, duke përfshirë aktivitetet e ndërmarrja në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të BE-së. <u>Nevojiten më shumë përpjekje për të forcuar kapacitetin kërkimor të</u>	1.1 Parashikimi i një buxheti të veçantë për trajnimet e administratës së Kuvendit.	Shërbimi i Burimeve Njerëzore, Shërbimi i Financës dhe i Buxhetit.	1.5 milionë lekë	2018	
	1.2 Trajnimi i vazhdueshëm i Shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme.	Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimin të Deputetëve në bashkëpunim me Drejtorët e Shërbimeve të Kuvendit.	Fondet vjetore buxhetore të Kuvendit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe donatorë të ndryshëm.	2018 dhe në vazhdim.	

<u>Parlamentit.</u>	1.3 Rishikimi i Strategjisë së Trajnimit për Stafin e Administratës së Kuvendit (<i>miratimi i strategjisë së trajnimit për periudhën 2019-2022</i>).	Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimin të Deputetëve, Byroja e Kuvendit.	Fondet vjetore buxhetore të Kuvendit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.	Janar 2019	
	1.4 Modernizimi i shërbimeve të Kuvendit me qëllim përshtatjen e tyre për t'u përballur me sfidat dhe kërkesat e reja për kapacitete dhe ekspertizë të nivelit të lartë që Kuvendi do të ketë gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.	Sekretari i Përgjithshëm, Shërbimi i Burimeve Njerëzore, Byroja e Kuvendit.	Fondet vjetore buxhetore të Kuvendit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe donatorë të ndryshëm.	2018	
2. <u>Nevojiten më shumë përpjekje për të forcuar lidhjet me zonat elektorale.</u> <u>Nuk është përfunduar akoma mbulimi i të 12 rajoneve me zyrat zgjedhore. Mënyrat e</u>	2.1 Për përfundimin e të gjithë procesit të hapjes së zyrave të deputetëve në qarqe, do të vazhdojë komunikimi zyrtar mes Kuvendit dhe organeve të pushtetit vendor, për të mundësuar hapjen e 12 zyrave të tjera, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin e Byrosë së Kuvendit për hapjen e 24 zyrave në të 12 qarqet e vendit.	Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimin të Deputetëve.	Buxheti i Shtetit.	Brenda vitit 2018	

<u>komunikimit midis qytetarëve dhe deputetëve duhet të formalizohen dhe të forcohen.</u>	2.2 Përmes funksionimit të këtyre zyrave, do të vazhdojë të intensifikohet komunikimi midis të zgjedhurve dhe shoqërisë civile përfshirë edhe nxënës të shkollave të mesme, për të përcjellë zërin e qytetarëve në procesin ligjvënës.	Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve.	Buxheti i Shtetit.	Brenda vitit 2018	
---	---	---	---------------------------	--------------------------	--